



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2022:229498
Datë: 17.05.2024
Numri i dokumentit: 05703323

K.DH.SH.II.nr.18/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania e Ujësjetës Rajonal “Mitrovica” Sh.A., me numër fiskal 600338033 dhe me seli në Mitrovicë, rr. “Liqeni” p.nr, kundër debitorit Komuna e Vushtrrisë, duke vendosur lidhur me ankesën e ushtruar të kreditorit, kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2593/22 të datës 06.11.2023, me datën 16.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetësi “Mitrovica” SH.A., me seli në Mitrovicë, rr. “Liqeni” p.nr në Mitrovicë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr. 2593/22 të datës 06.11.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar. KPPP.nr. 2593/22 të datës 06.11.2023, e ka pranuar si

të bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Vushtrrisë, ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 161/22, i lejuar më datë 20.10.2022, nga Përmbartuesi Privat Isa Shala ANULOHET.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori ushtruar, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbartimore, vërtetimit të gabuar të gjendjës faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj këtë ankesë dhe ta refuzoj prapësimin e debitorit.

Debitori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, P.nr. 161/22, i lejuar më datë 20.10.2022, në bazë të dokumentit të besueshëm: Faturës nr. K018239, ka lejuar Urdhrin Përmbartimor P.nr. 161/22, të datës 20.10.2022, me të cilin është urdhëruar debitori, që në afat prej 7 ditësh nga data e pranimit të urdhrin, kreditorit t'ia paguaj shumën prej EUR 44,363.49, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Ndërsa, debitori prapësimin e ka paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor me arsyetim se organi përmbartimor gabimisht ka konstatuar gjendjen faktike ngase nuk ka pasur humbje të ujit në rrjetin e ujësjellësit siç pretendon kreditori. Me tej, ka shtuar se nuk është e qartë se me çfarë mjete kanë konstatuar humbjet e ujit kur nuk ka pasur as ujëmatës për të llogaritur shpenzimet e ujit, andaj edhe faturimi nga kreditori është bërë në mënyrë paushallë. Ka shtuar se faturës mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbartimor i mungon afati i përmbushjes së detyrimit dhe rrjedhimisht nuk i plotëson kushtet nga neni 29 i LPP-së. Ndërsa, në fund ka theksuar se e njëjta faturë ka të meta ngase nuk është pranuar nga debitori

dhe se të njejtës i mungon vula apo nënshkrimi i personit të autorizuar. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin ta aprovoj si të bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se pretendimet e debitorit në prapësim nuk qëndrojnë për faktin se, ne kemi iniciuar procedurën përmbartimore në bazë të faturave - ekstrakteve konform nenit 29, pika 1.2 dhe 40.1 të LPP-së. Ndërsa, lidhur me pretendimet e kreditorit se nuk ka pasur ujëmatës dhe borxhi nuk dihet se si është ngarkuar, kreditori ka shtuar se deri te një ngarkesë e tilla ka ardhur në bazë të raportit të menaxherit të njësive në Vushtrri në konsultim me inxhinieret e lamisë përkatëse të cilët në bazë të dimensionit të gypit dhe gjatësisë së tij kanë ardhur në përfundim se është shpenzuar uji në sasinë e përcaktuar në dokument. Në fund, si provë ka bashkangjitur ekstraktet nga librat e kontabilitetit dhe raportit mbi humbje të ujit. Ndërsa, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar dhe urdhri të mbetet në fuqi.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim: Gjykata fillimisht nga përmbajtja e propozimit për përmbartim të paraqitur nga kreditori, gjeti se përkundër që kreditori i referohet në përgjigje në prapësim ekstraktit nga librat afariste, i njejtë propozimin për përmbartim e ka ushtruar mbi bazën e Faturës K018239. Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm ,sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Po ashtu gjykata duke u bazuar nga të lartcekura përkatësisht fatura në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që fatura e lartcekur është

pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se fatura është dorëzuar te debitori, pasi që e njëjta nuk mbanë vulën e pranimit apo nënshkrimin e personit përgjegjës në kuadër të debitorit, dhe si e tillë rezulton të jetë lëshuar njëanshëm nga ana e kreditorit, prandaj edhe nuk është e përshtatshme për përmbarrim.

Po ashtu gjykata ka vlerësuar edhe dokumentin – Ekstraktin nga librat afariste të cilit i është referuar kreditori dhe të cilin ekstrakt e ka dorëzuar së bashku me përgjigje në prapësim, mirëpo gjeti se i njëjti poashtu nuk i plotëson kushtet për të qenë dokumenti i përshtatshëm për përmbarrim në kuptim të nenit 29, pika 1.2 të LPP-së. Kjo për faktin se nga vet deklaratimet e kreditorit, rezulton se i njëjti ka faturuar borxh në emër të humbjeve të ujit në rrjetin publik të ujësjellësit dhe jo në emër të konsumit apo furnizimit me ujë. Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarrim, e mbi bazën e të cilit Përmbarruesi privat ka lejuar përmbarrimin, nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbarruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale dhoma e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarrimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës shihet qartë se fatura e larte cekur në rastin konkret nuk mund të vërtetohet se është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht me asnjë prove nuk është dëshmuara se fatura është dorëzuar te debitori , pasi që e njëjta nuk mbanë vulën e pranimit apo nënshkrimin e personit përgjegjës në kuadër të debitorit, dhe si e tille rezulton të jetë e një anshme nga ana e kreditorit, andaj dhe nuk është e përshtatshme për përmbarrim. Po ashtu shikuar Ekstraktin nga librat afariste në të

cilin i është referuar kreditori dhe të cilin ekstrakt e ka dorëzuar së bashku me përgjigje në prapësim, mirëpo gjeti se i njëjti poashtu nuk i plotëson kushtet për të qenë dokumenti i përshtatshëm për përmbarrim në kuptim të nenit 29, pika 1.2 të LPP-së. Kjo për faktin se nga vet deklaratimet e kreditorit, rezulton se i njëjti ka faturuar borxh në emër të humbjeve të ujit në rrjetin publik të ujësjellësit dhe jo në emër të konsumit apo furnizimit me ujë.

Andaj gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë i bazuar. Më te drejt gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se kreditori në rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht të vlefshme në mbështetje të pretendimeve të tij.

Përndryshe në procedurën përmbarrimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarrimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarrues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarrimin.

Gjykata vlerësoi pretendimet ankimore të kreditorit, por të njëjta mbesin të pabazuara pasi që të njëjtat pretendime janë vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë dhe për të cilat ka dhënë sqarime të mjaftushme për të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj pretendimet ankimore nuk kishin ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje përmbarrimore.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.18/24, me datë 16.05.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija Ymeri